

Analisti politik, Halil Matoshi ka reaguar ndaj një deklarate të ishpresidentes së vendit, Atifete Jahjaga.

Jahjaga tha se gjatë kohës sa ishte kriza politike në vend, ajo kishte koordinuar arrestimin e 60 të dyshuarve për pjesëmarrje në luftën në Siri. Matoshi në një shënim në facebook e ka quajtur fjali idiote, ato që i ka thënë Jahjaga.

Shënimi i plotë i Matoshit:

*Ni fjali idiote*

*“Në verën e vitin 2014 nën koordinimin tim, në kohën kur Kosova po kalonte nëpër krizë të thellë politike, organet e rendit dhe të drejtësisë kanë ndërmarrë operacionin më të madh për arrestimin e rreth 60 qytetarëve në nivel Kosove për pjesëmarrje në lufta të huaja dhe bashkangjitje organizatave terroriste”, ka shkruar Jahjaga.*

*Pos ne vendet diktatoriale askund ne demokraci ku pushtetet jane te ndame ni President/e shteti nuk koordinon arrestimet e qytetareve.*

*Kjo nuk asht pune presidentesh por policesh, hetuesish e prokuroresh oj Ti!*

*Qyre cfar analfabetsh funksional ngriten ne majat e pushtetit ne Kosoven tone te shtrenjte!???*

*Kjo Zoje, me gojen e vet po e deshmon sa vend i padrejte qe asht Kosova, me sistem te kapur e te dirigjuem drejtesie...*

*O Zot i madh cfare mjerimi shoqnor e degjenerimi mental – cfar zvarritjesh per me i dhane vetit fuqi e fame me qyke t’zorit!?*

*P.S.*

*Linguistet cinik kishin methane: Fjali budallice!*